



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore të *Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës*, më 4 mars, Trupi Gjykses urdhëroi palët dhe Administratoren të dorëzonin versionet e redaktuara publike të një numri parashtrimesh që ishin konfidenciale deri më sot. Afati është 10 marsi 2025.

Më 28 shkurt, Kryetarja e Dhomave të Specializuara lëshoi një vendim mbi kërkesën për sqarim të z. Bahtijari, në të cilën mbrojtësja e z. Bahtijari pretendoi se z. Bahtijari nuk u informua në kohë për uljen e dënimit të tij. Në vendimin e vet, Kryetarja Trendafilova sqaroi se z. Bahtijari jo vetëm që u informua për rezultatin e procedurës për uljen e dënimit dhe Vendimin, por mori edhe një kopje të kushteve dhe të pjesës vendimore të Vendimit në gjuhën shqipe. Ai mori gjithashtu të gjitha hollësitë logjistike të nevojshme lidhur me transferimin në Kosovë dhe lirimimin me kusht. Kryetarja sqaroi më tej se mbrojtësja e z. Bahtijari ishte gjithashtu në dijeni për të gjitha këto hollësi përpara se të dorëzonte kërkesën për sqarim. Për këtë arsye, Kryetarja hodhi poshtë kërkesën dhe urdhëroi Mbrojtjen e z. Bahtijari të dorëzonte versionin e redaktuar publik të kësaj kërkesë deri më 6 mars 2025.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, në faqen e internetit të DHSK-së tani mund të gjeni arsyetimin e hollësishëm të vendimit të Trupit Gjykses mbi Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë. Pasi ka vlerësuar provat, Trupi Gjykses është bindur se faktet e pranuar mbështeteshin në provat, dhe se secili prej të akuzuarve pranoi se ishte pjesë e një grupi që synonte të nxiste dëshmitarin 1 që të mos jepte dëshmi.

Në çështjen gjyqësore për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit të *Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, më 3 mars, Trupi Gjykses hodhi poshtë një kërkesë të Mbrojtjes së Veselit për apelim të vendimit të Trupit Gjykses për mospranim si provë të një dokument që kishte përdorur Mbrojtja e Veselit gjatë marrjes në pyetje të një dëshmitari. Trupi Gjykses konstatoi se autenticiteti i dokumentit në fjalë nuk mund të kundërshtohet mjaftueshëm gjatë marrjes në pyetje nga pala jothirrëse, duke pasur parasysh se dëshmitari përkatës kishte ndërruar jetë. Trupi Gjykses rikujtoi se i takon atij të vendosë mbi pranueshmërinë e provave.

Më 3 dhe 4 mars, Trupi Gjykses lëshoi tre vendime mbi redaktime të propozuara nga Prokuroria, Mbrojtja e Viktimave dhe Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve për dorëzimin e versioneve me më pak redaktime të transkripteve nga seanca të ndryshme. Në të tre vendimet, Trupi Gjykses miratoi redaktimet që ishin të domosdoshme për të mbrojtur identitetin e dëshmitarëve të mbrojtur dhe urdhëroi që pjesë të tjera të transkriptit të riklasifikohen si publike.





Më 3 mars u bë publik versioni i redaktuar publik i vendimit të Trupit Gjykses të datës 19 shkurt, mbi kërkesën e z. Thaçi për lirim të përkohshëm për arsye humanitare. Sikurse Gjykatësja e Procedurës Paraprake në vendimin e saj, edhe Trupi Gjykses hodhi poshtë kërkesën e z. Thaçi sepse nuk ishte bindur se gjendja shëndetësore aktuale e babait të z. Thaçi përbënte situatë bindëse që do të përligjte lirin e përkohshëm. Trupi Gjykses rikujtoi se, duke pasur parasysh rëndësinë që të paraburgosurit të mbajnë lidhje të ngushta me anëtarë të familjes, Trupi Gjykses kishte urdhëruar Zyrën Administrative të mundësonte vizita shtesë përmes videolidhjes me të dy prindërit e z. Thaçi.

Më 4 mars, Trupi Gjykses miratoi pjesërisht një kërkesë të Prokurorisë për të pranuar si provë dokumente në lidhje me zonën e Shalës dhe zonën e Karadakut. Trupi Gjykses lejoi pranimin si provë në rastet kur u bind se prova përkatëse ishte autentike dhe kishte lidhje me lëndën, duke siguruar se vlera provuese e tij nuk zhbëhej prej efektit dëmtues ndaj të akuzuarve.

Seanca e ardhshme në këtë çështje gjyqësore është caktuar për të hënë, 24 mars, duke filluar në orën 09:00 paradite.

Gjatë kësaj jave, u bënë publike një numër parashtrimesh të Prokurorisë lidhur me hetimet në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* për ndikim ndaj dëshmitarëve. Ato janë në dispozicion në faqen e internetit të DHSK-së.

